

Agjencia e Sigurimit të Depozitave

2006

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj!

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8873 datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave", kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2006.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është themeluar dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me praktikat më të mira në fushën e sigurimit të depozitave.

Gjatë vitit 2006 veprimtaria e ASD është fokusuar si në zhvillimet sasiore, ashtu edhe në ato cilësore.

Kështu, mjetet financiare të ASD për vitin 2006 kanë pësuar një rritje prej 31,7 % krahasuar me vitin 2005. Nga këto, të ardhurat nga investimet e mjeteve financiare janë rritur 15,45% krahasuar me vitin 2005, ndërsa të ardhurat nga primi vjetor dhe kontributi fillestar janë rritur me 15,26%, shifër kjo që përkon me nivelin e rritjes së depozitave të siguruara në sistemin bankar.

Gjatë vitit 2006 e në vijim, në zbatim të objektivave të saj, ASD mbështetur nga asistenca teknike e FSVC (projekti i USAID) ka përqëndruar punën e saj në drejtim të studimeve analitike për përmirësimin e harmonizimin e kuadrit rregullativ ligjor e nënligjor, me praktikat dhe udhëzimet më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave.

Kështu, ASD mbështetur edhe në rekomandimet e misionit teknik të FMN, përfundoi gjatë vitit 2006 Udhëzuesin mbi Proçedurat e Kompensimit.

Seminari teknik rajonal i zhvilluar në Tiranë më 30 Maj të vitit 2006, me temë "Çështje të Politikave Financiare të Skemave të Sigurimit të Depozitave në Vendet e Europës Juglindore" i organizuar në bashkëpunim me Autoritetin Mbikqyrës dhe Bankën Botërore, është pjesë e zbatimit të objektivit të ASD për edukimin e publikut dhe grupeve të interesit, i cili ndikoi në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e dialogut midis autoriteteve mbikqyrëse, skemave të sigurimit dhe anëtarëve të saj.

Në veprimtarinë e saj Agjencia është fokusuar në bashkëpunimin korrekt me bankat dhe degët e bankave të huaj anëtare të skemës sonë të sigurimit, në frymën e zbatimit të ligjit, të mirëkuptimit të ndërsjelltë e ruajtjes së marrëdhënieve korrekte reciproke.

Ne falenderojmë në mënyrë të veçantë Bankën e Shqipërisë (Autoritetin Mbikqyrës) dhe Ministrinë e Financave për bashkëpunimin dhe ndihmën e ofruar në drejtim të përmirësimit të ushtrimit të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe forcimit të rolit të saj si një aktor i rëndësishëm në sigurimin e stabilitetit bankar e financiar.

Dashamir Halilaj

Kryetar i Këshillit Drejtues

1. Të përgjithshme	4
1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe qëllimi i saj.	4
1.2 Organizimi dhe drejtimi	4
1.3 Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave	4
1.4 Mbi gjendjen e sistemit bankar	5
2. Veprimtaria e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave	6
2.1 Kontributi fillestar	7
2.2 Primi vjetor i sigurimit dhe politikat e tij	7
2.3 Kompensimi	7
2.4 Administrimi i Mjeteve Financiare	8
3. Gjendja e depozitave të siguruar dhe struktura e tyre	10
3.1 Ecuria e depozitave të siguruar	10
3.2 Struktura e depozitave të siguruar	11
3.3 Struktura dhe numri i depozituesve sipas niveleve të përcaktuara në ligj	12
4. Gjendja financiare e ASD	13
4.1 Struktura e bilancit dhe ecuria e tij	13
4.2 Kapitali dhe ecuria e tij	13
4.3 Fitimi dhe ecuria e tij	14
4.4 Kontrolli i librave dhe i llogarive të ASD	15
4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm	16
5. Bashkëpunimi i ASD me Autoritetin Mbikëqyrës dhe institucionet ndërkombëtare	16

SHKURTIMET

IADI	International Association of Deposit Insurers
EFDI	European Forum of Deposit Insurers
FDIC	Federal Deposit Insurance Corporation
SHKK	Shoqëritë e Kursim Kreditit
FSVC	Financial Service Volunteer Corpus
FSAP	Financial Sector Assessment Program
BR	Banka Raiffeisen
BA	Banka Alpha
BASH	Banka Amerikane e Shqipërisë
BKG	Banka Kombëtare e Greqisë
BBSH	Banka e Bashkuar e Shqipërisë
BPI	Banka e Parë e Investimeve
BISH	Banka Italo Shqiptare
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BNT	Banka Ndërkombëtare Tregtare
BE	Banka Emporiki
BPC	Banka ProCredit
BIS	Banka Italiane e Zhvillimit
BC	Banka Credins
BT	Banka Tirana
BKSH	Banka e Kreditit të Shqipërisë
BP	Banka Popullore
BU	Banka Union

1. Të përgjithshme

1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe qëllimi i saj

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, është krijuar në bazë të ligjit nr.8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”.

Qëllimi i krijimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është sigurimi dhe kompensimi i depozitave të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterve dhe niveleve të përcaktuara në këtë ligj.

Detyrimet e saj ligjore, Agjencia e Sigurimit të Depozitave i përmbush duke ndikuar në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, si dhe në forcimin e besimit tek publiku nëpërmjet shmangies së riskut të humbjes së kursimeve të tyre si pasojë e një falimentimi të mundshëm të ndonjë banke duke kontribuar në rritjen e mirëqenies ekonomike të vendit.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave bën pjesë në institucionet që krijojnë sigurinë financiare të sistemit, së bashku me Autoritetin Mbikëqyrës (Banka Qëndrore), dhe Ministrinë e Financave që është në funksionin e burimit të fundit financiar (*lender-of-last-resort*).

1.2 Organizimi dhe drejtimi i Agjencisë

Agjencia, në bazë të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, organizohet dhe administrohet nga Këshilli Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë të cilët emërohen nga Banka e Shqipërisë me propozimin si më poshtë:

- Dy anëtarë nga Banka e Shqipërisë,
- Dy anëtarë nga Ministria e Financave,
- Një anëtar nga Bashkimi Profesional i Ekspertëve Kontabël.
- Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson autoritetin ekzekutiv të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

1.3 Anëtarësimi në skemën e sigurimit

Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha bankat që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia.

Numri i bankave të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në fund të vitit 2006 është 17, të cilat janë banka private shqiptare apo të huaja si më poshtë:

1. Banka Italo Shqiptare
2. Banka Raiffeisen
3. Banka e Bashkuar e Shqipërisë
4. Banka Italiane e Zhvillimit
5. Banka Kombëtare Tregëtare
6. Banka Tirana
7. Dega e Bankës Kombëtare Greke Tiranë
8. Banka Ndërkombëtare Tregtare
9. Dega në Tiranë e Bankes Alpha
10. Banka Amerikane e Shqipërisë
11. Banka ProCredit
12. Banka e Parë e Investimeve
13. Banka Emporiki Shqipëri
14. Banka e Kreditit e Shqipërisë
15. Banka CREDINS
16. Banka Popullore
17. Union Bank

1.4 Mbi gjendjen e sistemit bankar¹

Gjatë vitit 2006, sistemi bankar vijoi zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Gjendja financiare e tij vlerësohet e kënaqshme, me një ecuri në nivele të mira dhe të qëndrueshme të treguesve të rentabilitetit; me një mjaftueshmëri të kapitalit mbi nivelin minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, por me një prirje të lehtë në rënie si shprehje e konsolidimit të tij.

¹Marrë nga vlerësimi i gjendjes financiare të sistemit bankar shqiptar, për tremujorin e katërt të 2006, analizur nga Autoriteti Mbikëqyrës

Gjatë këtij viti, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 127.7 miliardë lekë (ose 25.7 për qind), rreth 57.6 miliardë lekë më shumë se rritja e aktiveve e evidentuar në vitin 2005.

Teprica e kredisë së sistemit bankar, gjatë vitit 2006, shënoi rritje me 70.2 miliardë lekë² ose 55 për qind, nga 57.6 miliardë lekë për vitin e mëparshëm. Ecuria në rritje e kredidhënies flet për kërkesën e lartë të komunitetit për financim dhe për mundësitë gjithnjë në rritje të sektorit bankar për të përmbushur këtë kërkesë.

Shtirja e konsiderueshme në kredidhënie është shoqëruar me rritjen e madhësisë së portofolit të kredive me probleme, me rreth 3.1 miliard lekë ose 103 për qind krahasuar me fundin e vitit 2005. Në fund të vitit, treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë, i shprehur si raport i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive në terma bruto, llogaritet 3.1 për qind ndaj 2.3 për qind në fund të vitit 2005.

Rezultati neto i sistemit bankar për vitin 2006 rezultoi me fitim për rreth 7.45 miliardë lekë, rreth 12.9 për qind më shumë se viti 2005. Për vitin 2006, kjo shifër është 0.83 për qind e PBB,

krahasuar me 0.79 për qind një vit më parë.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, në fund të vitit 2006 paraqitet në nivelin 18.1 për qind, duke shënuar një rënie prej 0.5 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2005. Kjo rënie e lehtë e këtij raporti i atribuohet ritmeve të rritjes së krahasueshme të komponenteve të tij. Konkretisht, kapitali rregullator i sistemit është rritur me rreth 41 për qind, ndërsa totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me koeficientet e rrezikut, është rritur me rreth 45 për qind. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për vitin 2006 vazhdon të ruajë prirjen rënëse të shfaqur gjatë viteve të mëparëshme.

Bankat në përgjithësi vazhdojnë të shënojnë nivele të kënaqshme likuiditeti, ndërsa likuiditeti i sistemit paraqitet me tepricë.

Gjithashtu, depozitat pranë bankave, të cilat përbëjnë peshën kryesore të burimeve të sistemit, kanë patur prirje rritëse gjatë vitit 2006

²Teprica e kredisë në lekë është rritur me 24.4 miliardë lekë ose 78.2 për qind, ndërsa teprica e kredise në valutë është rritur me 45.7 miliardë lekë ose 47.4 për qind.

2. Veprimtaria e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, aktiviteti i së cilës rregullohet në Shqipëri nëpërmjet ligjit nr.8873 datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, siguron depozitat e individëve në sistemin bankar, kujdeset për përfshirjen në kohë të depozituesve në skemën e sigurimit të depozitave dhe kompenson depozitat në bankat të cilave ju hiqet (revokohet) licenca nga Autoriteti Mbikqyrës (Banka e Shqipërisë), deri në një shumë të caktuar.

Aktiviteti i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave përfshin përcaktimin e primit vjetor të sigurimit për bankat e nivelit të dytë, mbledhjen e kontributit fillestar dhe primit vjetor të sigurimit, verifikimin e saktësisë së përllogaritjes së këtij primi, investimin e mjeteve financiare, si dhe funksionin final kryesor për realizimin e detyrimit të pagesës së kompensimit të depozituesve të vegjël në bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Në përputhje dhe me direktivën 94/19 të Komunitetit Europian për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron të gjitha depozitat e individëve në lekë dhe monedhë të huaj, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikqyrës në ditën e ndërhyrjes. Agjencia siguron depozitat e individëve deri në 700 mijë lekë, me afat në lekë, depozitat me afat në valutë, depozitat pa afat në lekë, depozitat pa afat në valutë, çertifikatat e depozitave në lekë, çertifikatat e depozitave në valutë etj.

- Agjencia përjashton nga siguri dhe kompensimi depozitat e mëposhtme sipas dispozitave të këtij ligji (depozitat e pasiguruara):

- a) pjesa e depozitës mbi 700 000 (shtatëqind mijë) lekë ose e njëvlerëshmjë e saj në monedhë të huaj;
- b) depozitat e çdo shoqërie tregtare, personi fizik ose personi tjetër juridik;
- c) depozitat drejtorit, të administratorëve, të debitorëve të bankës së siguruar ose të çdo depozituesi tjetër, me të njëjtin

status në personat juridikë të lidhur me bankën në fjalë;

- d) depozitat e çdo personi që zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të drejtën e pronësisë të një aksioneri në masën 5 për qind (pesë për qind) ose më shumë në kapitalin e bankës së siguruar ose të aksioneve me të drejtë vote të lidhur me bankën në fjalë;
- e) depozitat e kontrollorëve dhe të ekspertëve kontabël të bankës së siguruar, ose të çdo depozituesi tjetër me të njëjtin status në personat juridikë të lidhur me bankën në fjalë;
- f) depozitat e çdo depozituesi të bankës së siguruar, që gëzon më shumë se 20 për qind (njëzet për qind) interes preferencial, të ndryshëm nga interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë të kësaj banke;
- g) depozitat e çdo personi në bankën e siguruar, që përdor llogarinë depozitë për veprimtari kriminale;
- h) depozitat jonominative, përfshirë depozitat në letrat me vlerë të prurësit;
- i) depozitat në degën e bankës jashtë Shqipërisë;
- j) depozitat e vendosura në bankën e siguruar gjatë dhe pas ditës së ndërhyrjes në këtë bankë.

2.1 Kontributi fillestar

Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha institucionet që ushtrojnë veprimtari bankare në vend. Sipas ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, nenit 23 të tij, çdo bankë e siguruar duhet të paguajë në Agjenci një kontribut fillestar të barabartë me 0.5 për qind të kapitalit të nënshkruar të bankës. Në ditët e para të vitit 2006 skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, iu shtua një subjekt i ri, “Union Bank” sh.a., e cila kreu dhe pagesën e kontributit fillestar në shumën 4.989.000,00

lekë, duke shënuar kështu një të ardhur për Agjencinë në përmbushje të nenit të mësipërm.

2.2 Primi i sigurimit dhe politikat e tij

Sipas nenit 24 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, për çdo bankë të siguruar, primi vjetor i sigurimit të depozitës është 0.5 përqind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune për tre muajt e fundit të vitit. Këtë prim të pagueshëm nga bankat e siguruara, Agjencia mund ta ulë deri në 0.1 për qind, vetëm në rast se mjetet financiare të saj, do të jenë jo më pak se 5 përqind të mesatares së këtyre depozitave, veprim i cili kryhet me akt nënligjor. Ky raport aktualisht është 1.9 për qind, nga 1.6 që ishte vitin e kaluar.

Përsëri bazuar në nenin 24 të ligjit të mësipërm, pagesa e primit bëhet në katër këste tremujore sipas afateve të përcaktuara në ligj. Njëkohësisht me pagesën e kështit të parë, bankat sjellin pranë Agjencisë deklaratën e primit e cila konfirmon llogaritjen e primit sipas kërkesave të ligjit. Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat përbëjnë dhe burimin kryesor të të ardhurave të Agjencisë, për vitin 2006 arritën në shumën 828,896 mijë lekë, e cila krahasuar me një vit më parë ka shënuar një rritje prej 15 për qind.

Në politikat e vitit 2006 të ASD, për bankat u aplikua e njëjta normë vjetore e primit të sigurimit të depozitave të tyre, sipas dispozitave të përcaktuara në ligj. Kjo normë vjetore e pagesës së primit është e njëjtë për të gjitha bankat, për arsye se në fillimet e tyre, sistemet e sigurimit duhet të përmbushin sa më shpejt qëllimin e sigurimit të fondeve të nevojshme për rritjen e nivelit të sigurimit në të ardhmen.

2.3 Kompensimi i depozitës së siguruar

Në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, janë përcaktuar nivelet për kompensimin e depozitave, me nivel maksimal

700 mijë lekë, e me një aplikim të co-insurance 15 për qind të pjesës mbi 350,000 lekë. Ky nivel i shumës së mbulimit (pra të siguruar) është afërsisht dy herë më i madh se GDP per capita në vendin tonë. Duke pasur parasysh qëllimin kryesor të funksionimit të skemave të sigurimit të depozitave, i cili është krijimi i besimit në sistemin bankar tek depozitorët e vegjël dhe depozitorët me një formim jo të mirë ekonomik, kjo shumë mbulimi e justifikon këtë qëllim.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” një nga detyrat kryesore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është kompensimi i depozitave të siguruara sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tre muaj nga dita e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës në bankën e siguruar. Pra, Agjencia është institucioni përgjegjës për realizimin e funksionit final të saj, kompensimit të depozitave të klientëve në kohë reale dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj.

Në përmbushje të këtij funksioni, një nga objektivat tona të vitit 2006 ka qënë përfundimi i fazës përgatitore për hartimin dhe implementimin e një softi për kompensimin e depozitave, e cila do të arrihet në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë, FSVC, GTZ dhe institucionet homologe. Për këtë, gjatë vitit të kaluar është punuar për hartimin dhe miratimin e “Rregullores së Kompensimit” dhe “Manualit të Proçedurave të Kompensimit”, duke përfunduar fazën përgatitore të procesit të studimit për hartimin e termave të referencës të këtij program.

2.4 Administrimi i mjeteve financiare

Mjetet financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave janë:

- së *pari*, kontributi i buxhetit të shtetit prej 400.000.000 lekë;
- së *dyti*, kontributet fillestare të bankave të porsaliçencuara;
- së *treti*, primet e bankave të siguruara;
- së *katërti*, fitimet e realizuara nga investimi i tyre.

Gjithashtu në mjetet financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave përfshihen edhe kredi, donacione apo subvencione të tjera, por të tilla deri më datë 31.12.2006 nuk ka patur.

Bazuar në ligjin nr. 8873 datë 29.03.2002, “Për sigurimin e depozitave” neni 9, pika 2; neni 21, si dhe në dokumentin e Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë, miratuar në Maj 2004, Agjencia e Sigurimit të Depozitave përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standartet e pranuar të menaxhimit të riskut. Administrimi i fondeve realizohet nëpërmjet investimit të mjeteve financiare të Agjencisë në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, dhe në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare të vendeve të tjera, monedha e të cilave është në llogari depozitë në bankën e siguruar, me maturim të mbetur jo më shumë se një vit.

Agjencia, për të bërë një menaxhim sa më të mirë të mjeteve të saj financiare dhe për të qenë në përputhje me kërkesat e ligjit, ka hartuar akte rregullative dhe ka ngritur strukturat e duhura për këtë qëllim. Dokumentet bazë, të miratuara nga Këshilli Drejtues i ASD që drejtojnë dhe kontrollojnë administrimin e mjeteve financiare janë Rregullorja dhe Manuali i operacioneve monetare, si dhe politikat e administrimit të mjeteve financiare.

Politika e administrimit të mjeteve financiare përcakton: investimet e lejueshme, strukturën e maturitetit, nivelet dhe përgjegjësitë e strukturave të Agjencisë në procesin e administrimit të mjeteve financiare.


Objekti i politikës së administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë është të ndërtojë një portofol investimesh me kushtet e mëposhtme:

1. nivel të pranuar rreziku dhe shlyerje.
2. afat maturimi nga momenti i blerjes, jo më shumë se 12 muaj.
3. nivel të lartë likuiditeti.


Struktura e portofolit të investimit sipas maturitetit të mbetur duhet të jetë si më poshtë;

- a) 30 deri në 40 % e Mjeteve Financiare duhet të jenë investuar në instrumente me maturitet të mbetur jo më shumë se 3 muaj
- b) 60 deri në 70 % e Mjeteve Financiare duhet të jenë investuar në instrumente me maturitet të mbetur mbi 3 muaj deri në 12 muaj.


Duke mbajtur parasysh konsideratën për maturitetin, shpërndarja e portofolit sipas maturitetit me 31.12.2006 rezulton si më poshtë.



Për sa i përket strukturës së portofolit të investimeve sipas monedhave, gjatë vitit 2006 Agjencia ka ruajtur benchmarkun e përcaktuar në politikat e administrimit të mjeteve financiare të saj në raportin 80% e portofolit në LEK dhe 20% e portofolit në monedhë të huaj, duke pranuar devijimet nga benchmarku prej + 3%.



Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë në vite të të ardhurave të krijuara nga investimi i mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave



3. Gjendja e depozitave të siguruara dhe struktura e tyre

3.1 Ecuria e depozitave të siguruara


Në fund të vitit 2006, totali i depozitave të sistemit është 525 miliard lekë, duke shënuar një rritje prej 20 për qind kundrejt fundvitit 2005. Depozitat e individëve rezultojnë përkatësisht me shumën prej 416 miliard lekë, duke zënë një peshë prej 79 për qind kundrejt totalit të depozitave në tërë sistemin bankar, prej të cilave, të siguruara janë 200 miliard lekë, të cilat të shprehura në përqindje përfaqësojnë rreth 48 për qind të depozitave të individëve. Pjesën më të madhe të depozitave të individëve e zënë depozitat në lekë dhe vetëm 34.5 për qind e tyre janë depozita në valutë.

Për periudhën njëvjeçare dhjetor 2005 – dhjetor 2006 vërehet një rritje prej 7.5 për qind e depozitave në valutë, dhe një rënie prej 3.5 për qind e depozitave në lekë (si % kundrejt totalit), e cila mund të gjejë shpjegim, nga oshilacionet e normave të interesit për depozitat në lekë, dhe tendenca e bankave të mëdha për të rritur depozitat në valutë.

Depozitat e individëve, gjatë kësaj periudhe njëvjeçare kanë shënuar një rritje prej 16 për qind, dhe ato të siguruara një rritje prej 10 për qind. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepet informacion mbi ecurinë e depozitave të sistemit gjatë periudhës 2004-2006.



mil / lekë

Nr.	Emërtimi	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006	Diferencat	
					4-3	5/3(%)
0	1	2	3	4	5	6
1.	Totali i depozitave	375.843	437.547	525.525	87.978	20
	Depozitat e kompanive	65.971	78.902	109.707	30.805	39
	Depozitat e individëve (a)	309.872	358.645	415.819	57.174	16
	Raporti (a) / tot.dep. ne %	82	82	79	----	----
2.	Depozitat e siguruara (b)	167.251	182.621	200.222	17.601	10
	raporti (b) / (a) ne %	54	51	48	----	----
	Ne lek	129.772	136.035	143.823	7.788	6
	Ne monedhe te huaj	37.479	46.586	56.400	9.814	21
3.	Depozitat e individeve jo te siguruara (c)	142.621	176.024	215.597	39.573	22
	raporti (c) / (a) ne %	46	49	52	----	----
	Ne lek	94.112	107.360	128.473	21.113	20
	Ne monedhe te huaj	48.509	68.664	87.123	18.459	27



3.2 Struktura e depozitave të sigururara



Në tregun bankar, Banka Raiffeisen vazhdon të ketë një rol dominant, duke zotëruar 46 për qind të depozitave të siguruarra të sistemit, por ky pozicion krahasuar me një vit më parë ka pësuar një rënie prej 20 për qind.



3.3 Struktura dhe numri i depozituesve sipas niveleve të përcaktuara në ligj

Nga të dhënat e fundit të vitit 2006 rezulton se 87 për qind e numrit depozituesve në sistemin bankar janë të mbuluar sipas skemës së sigurimit, d.m.th i kanë depozitat e tyre deri në 700 mijë lekë, kundrejt 83% ndaj vitit 2005 duke shënuar një rritje prej 4%. Këto raporte janë të pranueshme me kufijtë e përcaktuara për këtë qëllim nga këto skema.

Ilustrimi grafik i këtij informacioni jepet nga dy grafikët e mëposhtëm.



Të dhënat mbi numrin e depozituesve dhe të depozitave në 31 Dhjetor 2006 krahasuar me 31 Dhjetor 2005, jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Gjithsej	Prej të cilave		
			Deri 350 mijë	350 - 700 mijë	Mbi 700 mijë
0	1	2	3	4	5
1.	Mbajtesit e depozitave të siguruar				
	- 31.12.2005	834.951	602.789	92.975	139.187
	- 31.12.2006	1.201.600	944.245	99.311	158.044
	% ndaj totalit				
	- 31.12.2005	100	72	11	17
	- 31.12.2006	100	79	8	13
2.	Totali i depozitave të individëve (milion Lek)				
	- 31.12.2005	358.645	37.777	47.413	273.455
	- 31.12.2006	415.819	38.988	50.604	326.227
	% ndaj totalit				
	- 31.12.2005	100	11	13	76
	- 31.12.2006	100	9	12	78

2006

RAPORT VJETOR

4. Gjendja financiare e ASD

Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 8873 datë 29.03.2002, "Për sigurimin e depozitave", Agjencia mban llogari dhe rregjistra me qëllim që në cdo kohë të pasqyrohet në mënyrë të saktë gjendja financiare e saj, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" si dhe manualin kontabël të saj të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin Nr.250 datë 15.04.2005 "Për miratimin e Manualit Kontabël të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave". Zbatimi i këtij manuali, në mbajtjen e kontabilitetit gjatë vitit 2006 dhe në raportimin e pasqyrave financiare, ka ndikuar në një pasqyrim bashkëkohor më real e më transparent të gjendjes financiare të ASD.

Veprimtaria financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është përjashtuar nga tatimet dhe taksat e drejtpërdrejta.

4.1 Struktura e bilancit dhe ecuria e tij

Në mënyrë të përmbledhur dinamika e aktiveve dhe pasiveve të Agjencisë për vitin 2006 paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të bilancit

Përshkrimi (ne mijë leke)	31.12.2006	31.12.2005	Ndryshimi
Aktive të qëndrueshme	73.427	78.613	-5.186
Aktive korrente	3.830.350	2.885.452	942.950
TOTAL AKTIVE	3.903.777	2.964.065	937.764
Kapitali Agjencisë	3.902.689	2.961.990	938.751
Pasive të tjera	1.088	2.075	-987
TOTAL KAPITALI & PASIVE	3.903.777	2.964.065	937.764

4.2 Kapitali dhe ecuria e tij

Kapitali i Agjencisë është i përbërë nga fondi themeltar prej 400.000.000,00 leke, fitimi i pashpërndarë i viteve të kaluara prej 2.561.989.894,57 lekë, si dhe fitimi i vitit ushtrimor prej 940.699.232,00 lekë. Gjendja e këtij zëri në total më 31.12.2006 është 3.902.689.127,3 lekë.

PASQYRA E LËVIZJES SË KAPITALIT TË ASD

	31.12.2006	31.12.2005
KAPITALI I AGJENCISË		
• Kapitali (Fondi Themeltar)	400.000.000,00	400.000.000,00
• Kapitali (Fondi Themeltar I paguar)		
• Rezervat		
• Rezerva rivleresimi		
• Diferenca rivleresimi		
• Fitim/humbjet e pashpërndara	2.561.989.894,57	1.747.246.270,97
• Fitim/humbjet e vitit ushtrimor	940.699.232,73	814.743.623,60
Kapitali gjithsej i Agjencise	3.902.689.127,3	2.961.989.894,57

Kapitali i Agjencisë përbëhet nga elementët e mëposhtëm

- **Fondi themeltar**


Bazuar në nenin 19, të ligjit nr.8873, datë 29.03.2002, “Për sigurimin e depozitave”, gjatë muajit shkurt 2003, është derdhur nga Ministria e Financave, Fondi Themeltar prej 400.000.000,00 lekë, kontribut i buxhetit të shtetit.

- **Të ardhura të akumuluar**

Përfaqëson fitimin e pashpërndarë të realizuar nga aktiviteti i Agjencisë gjatë vitit 2002, 2003, 2004, 2005 në shumën 2.561.989.894,57 lekë

- **Të ardhurat e periudhës ushtrimore**

Përfaqëson fitimin e realizuar gjatë periudhës raportuese në shumën 940.699.232,73 lekë



4.3 Fitimi dhe ecuria e tij

Fitimi i ASD në vite realizohet nga zërat e mëposhtëm të të ardhurave.

- **Krijimi i të ardhurave**

Të ardhurat e Agjencisë për periudhën raportuese përbëhen nga:


Të ardhura nga kontributi fillestar i bankave të siguruar, të cilat përfaqësojnë pagesat e kontributeve fillestare nga bankat e siguruar në përputhje me nenin 23, pika 4 e Ligjit nr.8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Për vitin 2006 është derdhur kontribut fillestar në masën prej 4.984.000,00 lekë nga UNION BANK si banka më re e licensuar më 28.12.2005

Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat përfaqësojnë detyrimin ligjor të bankave të siguruar të primit vjetor të sigurimit të depozitave për vitin 2006, në shumën prej **828.896.525,58 lekë** dhe në zbatim të nenit 24, të ligjit nr.8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Të ardhurat nga Operacionet Monetare të cilat përfaqësojnë interesat aktive nga investimi i mjeteve financiare të Agjencise, në shumën 189.356.774,01 lekë (të ardhura të maturuara).

Të ardhura nga veprimtari të tjera, përfaqësojnë shumën prej 815.127,73 lekë.



4.4 Kontrolli i librave dhe llogarive të Agjencisë

Aktiviteti i Agjencisë për vitin 2006, llogaritë dhe regjistrat e saj janë audituar nga auditi i brendshëm. Nga ky auditim rezultoi se këto dokumenta paraqesin me vërtetësi treguesit financiarë të Agjencisë.

4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm

Lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2006, auditi i brendshëm ka patur si objektiv:

- vlerësimin e besueshmërisë për informacionin financiar dhe të drejtimit dhe,
- vlerësimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm

Në përfundim të auditimit, opinioni për pasqyrat financiare është se:

Të dhënat e paraqitura në bilancin kontabël, në pasqyrën e të ardhurave dhe në pasqyrën cash flow, pasqyrojnë në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të ASD në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250 datë 15.04.2005 “Për Manualin e Kontabilitetit të ASD”.

Për sa i përket vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, Këshilli Drejtues, Drejtoria e institucionit kanë ndërtuar infrastrukturën apo kuadrin rregullator që kanë ndikuar në menaxhimin me efektivitet të lartë të të gjithë praktikave që përbëjnë zhvillimin e aktivitetit të ASD.

Gjatë vitit të kaluar, ASD-ja ka siguruar tregues financiarë që e bëjnë shumë optimiste të ardhmen e misionit të saj. Situatë optimiste ka edhe lidhur me realizimin e treguesve të performancës, të cilat kanë ardhur gjithmonë në rritje dhe në përmirësim të ndjeshëm.

Përfundimisht, auditi i brendshëm shpreh opinionin, se pasqyrat financiare japin vërtetësinë e treguesve financiarë të përgatitur për vitin 2006 nga ASD.

2006

RAPORT VJETOR

5. Bashkëpunimi i ASD me Autoritetin Mbikëqyrës dhe institucionet ndërkombëtare

Gjatë vitit 2006 Agjencia e Sigurimit të Depozitave si një nga mekanizmat që ndihmojnë në ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar, vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin Mbikëqyrës (Bankën e Shqipërisë), nëpërmjet shkëmbimit reciprok të informacionit, duke konkretizuar në këtë mënyrë marrëveshjen e nënshkruar midis Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave si dhe duke respektuar ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Në këtë kuadër bashkëpunimi, Agjencia e Sigurimit të Depozitave jo vetëm vazhdon të njihet me raportet e ekzaminimeve në vend që Banka e Shqipërisë kryen konform programit të saj për të vlerësuar gjendjen financiare të bankave që operojnë në Shqipëri, por merr të dhëna periodike tremujore për gjendjen financiare të bankave të siguruara.

Në zbatim të udhëzimeve “Për procedurat e pranimit të bankave në skemën e sigurimit të depozitave”, “Mbi marrëdhëniet e ASD me bankat e siguruara” të miratura nga Banka e Shqipërisë, ASD ka dërguar periodikisht edhe gjatë vitit 2006 pranë Autoritetit Mbikëqyrës, informacione mbi kryerjen e pagesës së primit vjetor nga bankat e siguruara.

ASD vazhdon marrëdhëniet e saj me institucionet dhe organizmat ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave. Në muajin Maj të vitit 2006 një mision teknik i FMN, asistoi ASD në hartimin e procedurave për manualin e kompensimit, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve përkatëse.

Përsëri në fund të muajit Maj të vitit të kaluar, në Tiranë në bashkëpunim me programin Konvergjencë të Bankës Botërore, ASD dhe Banka e Shqipërisë organizuan seminarin teknik rajonal me temë: “Çështje të Politikave Financiare të Skemave të Sigurimit të Depozitave në Vendet e Europës Jug-Lindore”.

Qëllimi i organizimit të këtij seminari ishte: Përmirësimi i komunikimit në nivel ekspertësh midis Fondeve të Sigurimit për vendet e Europës Jug-Lindore

Përmirësimi i praktikave dhe politikave të menaxhimit financiar të skemave të sigurimit në vendet e rajonit.

Zhvillimi i informimit dhe i kuptimit të çështjeve të politikave financiare të Fondeve të Sigurimit të Depozitave nga anëtarët e skemave të sigurimit.

Përmirësimi i dialogut midis autoriteteve dhe anëtarëve të skemës së sigurimit

Shkëmbimi i eksperiencës dhe bashkëpunimi me vende të cilat kanë skema të ngjashme të sigurimit, ka qënë një nga prioritetet e Agjencisë për realizimin e funksioneve të saj kryesore, sigurimin dhe kompensimin e depozituesve në rast të ndonjë falimentimi të mundshëm të ndonjë banke. Kështu, në muajin Shtator 2006 ASD organizoi një vizitë të punonjësve të saj në Fondin e Malit të Zi, për të parë mënyrën e funksionimit të softit të kompensimit. Gjithashtu aty u organizua një takim me ekspertët sllovakë që kishin ndihmuar në hartimin e këtij softi, me të cilët u shkëmbyen mendime dhe eksperiencë lidhur me hapat që ishin ndjekur deri në implementimin e tij.

Edhe për vitin 2006 Agjencia e Sigurimit të Depozitave vazhdon të marrë pjesë me të drejta të plota të anëtarit në Shoqatën Ndërkombëtare të Sigurimit të Depozitave. Gjithashtu Agjencia e Sigurimit të Depozitave është anëtare edhe në Forumin European të Sigurimit të Depozitave.

Njohuritë e përfituara nga bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare si IADI, EFDI, shkëmbimi i eksperiencës me vendet anëtare të tyre, si dhe asistenca e veçantë e ofruar nga projekti i FSVC, ndihmuan në hartimin dhe finalizimin e Rregullores së Kompensimit

dhe Manualit të Proçedurave të Kompensimit, dokumente bazë për përgatitjen e termave të referencës së programit informatik të pagesës së depozituesve në rast kompensimi.

Edhe gjatë vitit 2006 Agjencia ka punuar në vazhdimësi për të bërë të njohur tek depozituesit skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e saj në procesin e kompensimit në rast të ndonjë falimentimi të ndonjë banke.

ASD ka pasuruar në mënyrë të vazhdueshme faqen e saj të internetit me dokumente, materiale e informacione të cilat mundësojnë informimin e publikut në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave dhe procesin e kompensimit në rast të falimentimit të ndonjë banke mbështetur në ligjin nr. 8873 datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave".

Gjithashtu Agjencia e Sigurimit të Depozitave vazhdon të informojë depozituesit nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë të cilat operojnë në Shqipëri, si nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese si broshura shpjeguese, fletëpalosjet informuese, ashtu dhe me prezencën e detyrueshme të logos së ASD e cila është e vendosur në të gjitha bankat.

ASD ka bashkëpunuar me median e shkruar edhe gjatë vitit 2006, shkrime informative janë botuar në median e shkruar lidhur me funksionin e Agjencisë, veprimtarinë dhe çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurimin e depozitave.

BILANCI PERMBLEDHES

(per periudhen 01.01.2006 deri me date 31.12.2006)

AKTIVET (në lekë)		PERIUDHA		DIFERENCA	
		31.12.006	31.12.2005	ne leke	ne %
A	Mjete Monetare dhe ekuivalente	170.030.709,90	9.868.215,22	160.162.494,68	1.723,01
	1. Mjete monetare prane B. Shqiperise	1.932.054,49	6.617.841,91	-4.685.787,42	29,19
	2-Ekuivalente te mjeteve monetare	0,00	0,00	0,00	
	3 Llogari administrative prane bankave	168.098.655,41	3.250.373,31	164.848.282,10	5.171,67
	* ne leke (Raiffeisen Bank)	386.925,52	0,00	386.925,52	0,00
	* ne leke (BKT Tirana 3)	1.162.661,20	2.760.134,41	-1.597.473,21	42,12
	* ne valuta (RaiffeisenBank)	353.553,50	0,00	353.553,50	0,00
	* ne valuta (BKT Tirana 3)	542.676,90	0,00	542.676,90	0,00
	* ne valuta (State Street Bank)	165.652.838,29	490.238,90	165.162.599,39	33.790,23
	4. Arka	0,00	0,00	0,00	0,00
B	Investime ne letra me vlere te Qeverise	3.496.336.263,10	2.731.039.611,10	765.296.652,00	128,02
	1- Investime ne LVL te Qeverise Shqiptare	2.986.732.393,00	2.197.830.000,00	788.902.393,00	135,89
	2- Investime te LVL te Qeverive te Huaja	509.603.870,10	533.209.611,10	-23.605.741,00	95,57
C	Llogari te Arketueshme	163.838.151,80	144.544.207,71	19.293.944,09	113,35
	1- Prime te arketueshme	207.174.659,00	179.256.597,00	27.918.062,00	115,57
	2- Interes I Arketueshem (Bono Thesari)	-66.181.189,00	-51.416.595,00	-14.764.594,00	128,72
	3- Interes I perlllog si e ardhur (LVL)	20.003.046,57	12.411.915,84	7.591.130,73	161,16
	4- Kerkesa per arketim ndaj Bankave te falimentuara	0,00	0,00	0,00	0,00
	5- (-) Zhvleresimi I kerkesave per arketim	0,00	0,00	0,00	0,00
	6- Skonto, cmimi, primi LVL	2.761.899,23	4.292.289,87	-1.530.390,64	64,35
	7- Te tjera te arketueshme (debitore)	79.736,00	0,00	79.736,00	0,00
D	Aktive te tjera	73.572.297,50	78.612.674,80	-5.040.377,30	93,59
	1-Aktive te Qendrueshme	72.701.211,10	78.058.963,50	-5.357.752,40	93,14
	a- Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara	0,00	0,00	0,00	0,00
	b- Aktive te Qendrueshme te Trupezuara	89.644.037,30	89.644.037,30	0,00	100,00
	(-) Zhvleresim I Akumuluar I AQ	-16.942.826,20	-11.585.073,80	-5.357.752,40	146,25
	2- Materiale	726.057,40	553.711,30	172.346,10	131,13
	3- Shpenzime per tu shperndare	145.029,00	0,00	145.029,00	0,00
	TOTALI	3.903.777.422,30	2.964.064.708,83	939.712.713,47	131,70
	Llogari Jashte Bilancit	0,00	0,00	0,00	0,00
	Kerkesa per arketim	0,00	0,00	0,00	0,00
	Te tjera llogari angazhimesh	0,00	0,00	0,00	0,00

DETYRIMET DHE KAPITALI (PASIVET)		PERIUDHA		DIFERENCA	
		31.12.006	31.12.2005	ne leke	ne %
A	DETYRIME	1.088.295,00	2.074.814,26	-986.519,26	52,45
	I. Detyrime Afat shkurtra	1.088.295,00	2.074.814,26	-986.519,26	52,45
	1. Kompensimi I depozitave te siguruara	0,00	0,00	0,00	0,00
	2. Detyrime Sigurime Shoqerore	313.542,00	356.841,00	-43.299,00	87,87
	3. Tatim te ardhurat Personale	328.617,00	414.080,00	-85.463,00	79,36
	4. Te tjera	139.400,00	666.454,06	-527.054,06	20,92
	* te tjera te ngjashme	79.736,00	0,00	79.736,00	0,00
	5.Kred/ Hua Afatshkurtra	0,00	0,00	0,00	0,00
	6.Shpenzime te llogaritura (40.40)	227.000,00	637.439,20	-410.439,20	35,61
	II. Detyrime Afatgjata	0,00	0,00	0,00	0,00
	1. Kredi/Hua Afatgjata	0,00	0,00	0,00	0,00
	2. Kreditore te tjere	0,00	0,00	0,00	0,00
	III. Provigjone	0,00	0,00	0,00	0,00
	1. Provigjone te pergjitheshme	0,00	0,00	0,00	0,00
	2. Provigjone per humbje nga falimentimi	0,00	0,00	0,00	0,00
	3. Provigjone te tjera	0,00	0,00	0,00	0,00
	B TE ARDHURA TE MARA NE AVANCE	0,00	0,00	0,00	0,00
	C SUBVENCIONE DHE DONACIONE	0,00	0,00	0,00	0,00
	FONDE	3.902.689.127,30	2.961.989.894,57	940.699.232,73	131,76
	I. Fondi themeltar (kapitali I themelimit)	400.000.000,00	400.000.000,00	0,00	100,00
D	II. REZEVAT	0,00	0,00	0,00	0,00
	III. Fondi I Akumuluar	2.561.989.894,57	1.747.246.270,97	814.743.623,60	146,63
	IV. Fitimi dhe Humbja (-) e vitit Ushtrimor	940.699.232,73	814.743.623,60	125.955.609,13	115,46
	TOTALI	3.903.777.422,30	2.964.064.708,83	939.712.713,47	131,70
	LLOGARI JASHTE BILANCIT	0,00	0,00	0,00	0,00
	Te ardhura ne pritje per arketim	0,00	0,00	0,00	0,00
	Te tjera llogari angazhimesh	0,00	0,00	0,00	0,00

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(per periudhen 01 Janar deri 31 DHJETOR 2006 ne leke)

PASQYRA E TE ARDHURAVE		PERIUDHA		DIFERENCA	
		31.12.006	31.12.2005	ne leke	ne %
A	Nga veprimaria e sigurimeve	834.695.653,31	719.126.106,82	115.569.546,49	116
	1. Te ardhura nga Kontributi fillestar	4.984.000,00	0,00	4.984.000,00	
	2. Te ardhura nga primet	828.896.525,58	719.126.106,82	109.770.418,76	115
	3. Te ardhura te tjera qe lidhen me to	0,00	0,00	0,00	0,00
	*per veprimet me thesarin dhe nderbankare	144.463,73	0,00	144.463,73	
	*per veprimet me klientet	670.664,00	0,00	670.664,00	
B	Nga veprimtarite operative	189.356.774,01	155.889.848,99	33.466.925,02	121
	1. Te ardhura nga interesi I depozitave	0,00	0,00	0,00	0,00
	2. Te ardhura nga interesi I Letrave me Vlere	189.356.774,01	155.889.848,99	33.466.925,02	121
	a- te Qeverise Shqiptare	158.772.388,00	130.631.787,00	28.140.601,00	122
	b. te Qeverive te Huaja	30.584.386,01	23.567.619,92	7.016.766,09	130
	c. te ardhura te tjera qe lidhen me to	0,00	1.690.442,07	-1.690.442,07	0,00
C	Rimarje provigjonesh	0,00	0,00	0,00	0,00
D	Te ardhura nga falimentimi	0,00	0,00	0,00	0,00
E	Te ardhura te tjera	0,00	58.941,62	-58.941,62	
TOTALI A+ B+ C+ D+ E		1.024.052.427,32	875.074.897,43	148.977.529,89	117
A	Shpenzimet Operative	25.729.508,45	34.841.617,83	-9.112.109,38	74
	1. Shpenzime materiale dhe te ngjashme	9.197.417,72	15.667.621,72	-6.470.204,00	59
	2. Shpenzime financiare;nga keto	0,00	13.496.748,31	-13.496.748,31	
	a. interesa per Kredi/Hua (kom)	0,00	0,00	0,00	0,00
	b. Komisione bankare	1.584.881,87	1.496.033,15	88.848,72	106
	c. Te tjera (te paparashikuara)	0,00	200.974,00	-200.974,00	0
	d. shpenzime per zvleresim te LVL	9.589.456,46	11.799.741,16	-2.210.284,70	81
	3. Amortizimi I Aktiveve te Qendrueshme	5.357.752,40	5.590.798,00	-233.045,60	96
	4. Kuota e shpenzimeve per t'u shperndare	0,00	0,00	0,00	0,00
	5. Te tjera	0,00	86.449,80	-86.449,80	
B	Shpenzime Personeli	25.724.565,00	25.489.656,00	234.909,00	101
	1. Paga + shperblime	22.164.766,00	17.802.605,00	4.362.161,00	125
	2. Sigurime shoqerore	3.136.816,00	3.000.464,00	136.352,00	105
	3. Te tjera te ngjashme	422.983,00	4.686.587,00	-4.263.604,00	9
C	Tatime Taksa e te ngjashme	0,00	0,00	0,00	0,00
D	PROVIGJONE	0,00	0,00	0,00	0,00
E	TE TJERA OPERATIVE	31.899.121,14	0,00	31.899.121,14	
	1. Shpenzime Bordi	2.527.491,00	0,00	2.527.491,00	
	2. Diferenca konvertimi	3.330.499,14	0,00	3.330.499,14	
	3. Diferenca rivleresimi te LVL (renie e kursit)	26.041.131,00	0,00	26.041.131,00	
F	Shpenzime Falimentimi	0,00	0,00	0,00	0,00
G	Shpenzime te periudhave te kaluara	0,00	0,00	0,00	0,00
H	Shpenzime te jashtezakoneshme	0,00	0,00	0,00	0,00
K	TE TJERA	0,00	0,00	0,00	0,00
TOTALI A+ B + D + E + F + G + H + K		83.353.194,59	60.331.273,83	23.021.920,76	138
REZULTATI		940.699.232,73	814.743.623,60	125.955.609,13	115

PASQYRA E FLUKSEVE TE ARKES

(Per daten 31.12.2006 ne Leke)

PASQYRA E FLUKSEVE TE ARKES	PERIUDHA		DIFERENCA	
	31.12.006	31.12.2005	ne leke	ne %
Aktivitete e veprimtarise se perditeshme	0,00	0,00	0,00	0,00
* Fitimi (Humbja) e vitit ushtrimor	940.699.323,70	814.743.626,60	125.955.697,10	115
* (rritje ne interesat per t’u arketuar)	0,00	0,00	0,00	0,00
rritje e primit per tu arketuar	-27.918.062,00	0,00	-27.918.062,00	0,00
* Rritje ne interesat per t’u paguar	0,00	182.048.382,00	-182.048.382,00	0,00
* Fonde rezerve	0,00	0,00	0,00	0,00
Amortizimi investimeve ne maturim	8.624.117,90	0,00	8.624.117,90	
* (Transferim nga fonde rezerve)	0,00	0,00	0,00	0,000
* Amortizimi	5.357.752,40	11.585.073,80	-6.227.321,40	46
te tjera	0,00	0,00	0,00	0,00
* Fitimi nga shitja e mjeteve te qendrueshme	0,00	0,00	0,00	0,00
* Efekti i zerave te tjere te perlllogaritur	0,00	0,00	0,00	0,00
A- Fluksi hyres neto ne para nga aktivitetet e veprimtarise se perditeshme (A)	926.763.132,00	1.008.377.082,40	-81.613.950,40	92
* Rritja (renia) ne BTH dhe bonot e tjera	0,00	-2.197.830.000,00	2.197.830.000,00	0,00
- Rritja (renia) ne huate dhe paradh. Inst. Kredit	0,00	0,00	0,00	0,00
- Rritja (renia) ne huate dhe paradh. per klientet	0,00	0,00	0,00	0,00
- Rritja (renia) ne huate dhe paradh. per Qeverin	0,00	0,00	0,00	0,00
- Rritja (renia) ne letrat me vlere te vendosjes	0,00	-549.913.816,81	549.913.816,81	0,00
- Rritja (renia) ne mjetet e tjera	-317.375,00	-553.711,30	236.336,30	
- (Rritja) renia ne detyrimin ndaj Instit. te kreditit	0,00	0,00	0,00	0,00
- (Ritja) renia ne detyrimin ndaj klienteve	0,00	-871.246,00-	871.246,00	0,00
- (Rritja) renia ne ne borxhet e perfaq,letrat me vlere	0,00	0,00	0,00	0,00
- (Rritja) renia ne detyrimet e tjera	-985.519,00	-566.129,06	-419.389,94	174
- (Rritja) renia ne ndihmat dhe financim publik	0,00	0,00	0,00	0,00
- (Rritja) renia ne borxhin e varur	0,00	0,00	0,00	0,00
B- Fluksi neto hyres i arkës nga aktivitetet e veprimtarise se perditeshme (B) I= (A+ +/-	925.460.238,00	-1.741.357.820,77	2.666.818.058,77	-53
*Taksimi	0,00	0,00	0,00	0,00
* Pagimi i taksave mbi te ardhurat	0,00	0,00	0,00	0,00
Veprimtarite INVESTUESE	0,00	0,00	0,00	0,00
* (Blerja e letrave me vlere te investimit)	-765.296.652,00	0,000	-765.296.652,00	
* (Blerja e interesave pjesemarrrese dhe filialeve)	0,00	0,00	0,00	0,00
* Shitje e letrave me te investimit	0,00	0,00	0,00	0,00
* Dividentet e marre	0,00	0,00	0,00	0,00
* Blerje te mjeteve te qendrueshme	0,00	-1.800.000,00	1.800.000,00	0,00
* Shitje e mjeteve te qendrueshme	0,00	0,00	0,00	0,00
C- Fluksi Hyres neto i arkës perpara financimit (C) I = (B) +/- ...I	160.163.586,00	-1.743.157.820,77	1.903.321.406,77	-9
-Veprimtarite e Financimit	0,00	937.162.611,00	-937.162.611,00	0,00
emetimi i aksioneve te reja te zakonsh,	0,00	810.083.659,97	-810.083.659,97	0,00
dividentet e paguar	0,00	0,00	0,00	0,00
D- Fluksi dales neto i arkës nga veprimtarite e financimit (D) I C +/- ..I	0,00	3.120.689,32	-3.120.689,32	0,00
*Rritja neto e arkës dhe gjendjeve ne Banka	0,00	3.120.689,32	-3.120.689,32	0,00
*Arkë dhe Bankat ne fillim te vitit	9.868.215,22	6.747.525,90	3.120.689,32	146
*Arkë dhe Bankat ne fund te vitit	170.030.709,90	9.868.215,22	160.162.494,68	1.723